

Shtesë nga Prof. Jamarbër Malltezi në kërkesën drejtuar Gjykatës:

Të nderuar gjyqtarë,

Meqenëse ka një vendim të pabazuar në ligj që më ndalon komunikimin me askënd tjetër përveç atyre që banojnë në të njëjtën banesë – për pasojë as me avokatët pasi ata nuk banojnë në të njëjtën banesë – po ju shkruaj disa pika shtesë në kërkesën që po depozitohet në Gjykatë.

Vijoj i burgosur politik prej thujse 20 muajsh me urdhër të Edi Ramës dhe Taulant Ballës dhe nënshtrimin total të prokurorëve, por edhe të gjyqtarëve që janë vetuar nga motra e zv. Kryeministres Balluku, që vijnë në inspektohen nga vëllai i ish ministrit Gjermani dhe ish perfaqësues kryesor i fondacionit Soros, Artur Metani, dhe që përgjohen deri tek familjarët e tyre nga BKH nën urdhrat e SPAK që është vetë palë në proces. Unë nuk dëshiroj të heq dorë nga e drejta ime kushtetuese për një gjykatë të pavarur të krijuar me ligj dhe që nuk shantazhohet nga prokurorët e SPAK.

Po shkruaj haptaz (që Gjykata Kushtetuese të mos vetë-turpërohet më pas duke shkruar se nuk janë ngritur pretendimet për ndikim politik të procesit, sikur ka ndodhur me parë për turpin e këtij sistemi) që ky proces është një farsë politike e ngritur me porositë e kundraligjshme të diplomatëve Gabriel Escobar¹, Yuri Kim², dhe urdhrat politik të Edi Ramës në Kongresin e Partisë Socialiste (PS) më 09.04.2022³ dhe Asamblenë e PS më 07.05.2022⁴.

Procedimi penal nisi me kallzimin e rremë të Taulant Ballës në vitin 2020 – asokohe Sekretar i Përgjithshëm i PS dhe Kryetar i Grupit Parlamentar të PS – kinse toka ishte shpronësuar nga Italianët. SPAK nisi procedimin penal brenda ditës ndonëse e kish të qartë që ishte kallzim i rremë pasi Fletoret Zyrtare të 1942-1943 që janë online për këdo konfirmojnë se prona i mbeti familjeve pronare. Edhe sot që kanë shpenzuar miliona lekë dhe energji qoftë në Arkiv të Shtetit dhe qoftë duke marrë dhjetëra mijëra faqe nga Arkivat Italiane, SPAK ndonëse fakti se Taulant Ballës kreu kallzim të rremë, sërish refuzon të nisë procedim penal.

Ky është sulm politik përmes organeve të politizuara në ekstrem. Përveç emërimeve të prokurorëve dhe gjyqtarëve që kaluan filtrat e ministereve të Edi Ramës, Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja emëroi aktivistin e PS (B. Karaxha) si OPGJ në BKH dhe e përdori si personin kryesor qoftë për të kryer sekuestro pa vendim gjykatë, qoftë për të frikësuar e kërcënuar qytetarë dhe dëshmitarë.⁵ Aktivistë të tjerë të PS u punësuan si OPGJ pranë BKH (që urdhërohet nga SPAK) dhe të afërm të tyre u keqpërdorën nga SPAK për ekspertizë të rreme e të papranueshme (psh. ish militanti i PS Aldi Zyba u emërua si OPGJ në BKH,⁶ ndësa babai Aleks Zyba u caktua nga SPAK për të kryer ekspertizë topografike pa qenë fare inxhinier gjeodet dhe në konflikt interesi).⁷

¹ <https://dosja.al/e-for-te-berisha-kerkon-prova-per-akuzat-escobar-ku-jane-hetuesit-vendas-hetoni>

² <https://sot.com.al/politike/pasi-kerkoi-hetime-per-berishen-yuri-kim-takon-prokuroret-e-spak-thirrj-i464161>

³ <https://boldnews.al/2022/04/09/edi-rama-kerkon-hetimin-e-sali-berishes-nga-spak/>

⁴ <https://dosja.al/rama-spak-durimi-yne-po-soset-e-kemi-goje-ne-vend-dhe-ne-hetoni-non-grata-n>

⁵ <https://www.syri.net/politike/703271/foto-kamikazi-i-ps-kercenon-deshmitaret-ne-procesin-kunder-kryetarit-te-opozites/>

⁶ <https://joq-albania.com/artikull/1259672.html>

⁷ <https://www.syri.net/politike/719853/skandali-malltezi-topografi-qe-caktoi-spak-militant-i-ps-i-biri-patronazhist-dhe-hetues-i-bkh/>




Foto: Ulsi Manja në aktivitete politike me B. Karaxha që më pas e emëroi si OPGJ në BKH

Në këtë farsë nuk ka fare fakt penal, nuk ka asnjë dëm, ka vetëm kthim të sendit të vjedhur nga hajduti me petkun shtet tek qindra pronarët legjitimë, dhe zhvillim privat i pronës private nga 3 prej trashëgimtarëve të pronarëve sic e kanë vlerësuar vetë privatisht, duke mos nxjerrë me forcë asnjë nga 42 familjet informale që halli i kish bërë të jetonin në kushte të vështira në rrënojat e ish klubit, por perkundrazi duke zgjidhur hallin e strehimit të gjithë atyre familjeve. Nuk ka fare vepër penale se është zhvillim privat i pronës private dhe as nuk ka vepër sipas nenit 287.

Edhe sot, SPAK ndonëse ka mbledhur mbi 120,000 fletë palidhje, prapë nuk ka asnjë copë letër se si u be shteti pronar i tokës kur aty ishin pronarë familjet themeluese të Tiranës sic është vërtetuar me kontrata të para 90 viteve dhe nga vetë matjet e Italianëve të para 85 viteve. Pra, shteti as nuk e ka blerë, as nuk e ka këmbyer, asgjë. Si e fitoi pronësinë? Thjesht e grabiti pa asnjë letër. SPAK sot po mbron interesat e grabitësit shtet komunist, apo narkoshtet i kapur i Edi Ramës. Duket si rasti që hajduti pasi e grabit tokën, më pas të bën edhe akuzë biles edhe gjyq.

SPAK ka regjistruar një procedim penal brenda dites (01.12.2020), bazuar vetëm në kallëzimin e rremë të paraqitur nga z. Taulant Balla, – asokohe Sekretar i Përgjithshëm i PS dhe Kryetar i Grupit Parlamentar të PS – kinse toka ishte shpronësuar nga Italianët, kur Fletoret Zyrtare tregonin qartë që në momentin fillestar të kundërtën e fakteve të parashtruara nga kallëzuesi dhe pa qenë kompetente për të hetuar këtë çështje penale, sepse regjistrimi i procedimit penale në vitin 2020 është pa emër personi nën hetim (apo personi që i atribuohet vepra penale) dhe SPAK nuk kishte kompetencë për shkak të subjektit, si dhe nuk ka pasur kompetencë për shkak të veprës sepse neni 287 i Kodit Penale, nuk përfshihet në veprat penale të parashikuara.

Rregjistrimi i procedimit penal është kryer (i) duke paracaktuar fundin e hetimit (personat që do merreshin të pandehur si armiq të PS) dhe kjo (ii) ka shmangur pjesëmarrjen dhe kontrollin e hetimeve sipas të drejtave të përcaktuara në KPP edhe pse hetimi është kryer ndaj z. Malltezi dhe fëmijëve të tij, dukshëm që në vitin 2021.

SPAK refuzoi të pranojë qoftë artikujt e shumtë mediatike ku pasqyrohen urdhërat politike të Edi Ramës dhe ish diplomatëve Gabriel Escobar dhe Yuri Kim për të proceduar penalisht Sali Berishën për çfarëdo që të munden, qoftë dy DVD me urdhërat publik të Edi Ramës drejtuar

SPAK për të hetuar dhe proceduar Sali Berishën qoftë në Kongresin e Partisë Socialiste (PS) më 09.05.2022 dhe qoftë në Asambleenë e PS më 07.05.2022 ku Edi Rama ju drejtuar me fjalët: **“Jemi vetëpërmbytur deri ku tani nuk mban më, përballë kësaj talljeje të madhe. Durimi ynë po sosit. Zonja dhe zotërinj të SPAK-ut Zgjohuni! Po deligjitimohet SPAK-u dhe i gjithë sistemi i ri i drejtësisë!”**⁸ Edhe gjyqtarja e hetimeve paraprake (që ishte qoftë në konflikt interesi pasi ishte shkarkuar nga KLD e kryesuar nga Presidenti Berisha në 1996, dhe qoftë nuk përmbushte kushtet për të qenë gjyqtare) nuk i pranoi këto fakte publike të presionit politik nga Edi Rama. Vetëm në seancën e shqyrtimit paraprak u pranuan shumë prej tyre.

Fill pas urdhrave të Edi Ramës drejtuar SPAK në Kongresin e PS më 09.04.2022, brenda 5 javesh (15.04. – 20.05.2022) SPAK ka nisur një breshëri me 16 kërkesa drejtuar gjithë institucioneve duke kërkuar informacione për Sali Berishën dhe 3 breznive të tij qysh prej 30 vitesh deri tek mbesat e palindura ende të tij asokohe. Pra fillimisht shënjestrohet “Armiku i PS” sipas urdhrit publik të Edi Ramës dhe më pas kërkohen informacione për 30 vjet e jo për çështje konkrete.

NR.	NR. AKTIT	DATA AKTIT	AKTI	ORGANI	DREJTUAR	VOLUMI-FAQE
1	NR. 3164 Prot. (E.M.)	15.04.2022	KERKOHET DOKUMENTACION	SPAK	BASHKISE TIRANE	volumi 15 faqe 294
2	NR. 3165 Prot. (E.M.)	15.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE	volumi 42 faqe 218
3	NR. 3166 Prot. (E.M.)	15.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT	volumi 29 (file 4) faqe 47
4	NR. 3606 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT	volumi 30 faqe 27
5	NR. 3607 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	ILDKPKI	volumi 38 faqe 2
6	NR. 3608 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	MINISTRISE SE DREJTISE DREJTORISE SE TEKNOLOGJISE DHE INFORMACIONIT	volumi 91 faqe 175
7	NR. 3609 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	INSTITUTIT TE SIGURIMEVE SHOQERORE	volumi 35 (file 3) faqe 22
8	NR. 3610 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE SHERBBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR	volumi 35 (file 1) faqe 224
9	NR. 3611 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE DOGANAVE	volumi 35 (file 3) faqe 39
10	NR. 3612 Prot. (E.M.)	29.04.2022	KERKOHEN TE DHENA	SPAK	DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE	volumi 42 faqe 182
11	NR. 3871 Prot. (E.M.)	10.05.2022	KERKOHEN AKTE	SPAK	DREJTORISE SE DREJTIMIT TE PRONAVE PUBLIKE, MINISTRISE SE FINANCIVE DHE EKONOMISE	volumi 12 (file 1) faqe 2
12	NR. 3872 Prot. (E.M.)	10.05.2022	KERKOHEN AKTE	SPAK	AGJENSISE SE TRAJTIMIT TE PRONAVE TIRANE	volumi 8 faqe 2
13	NR. 4136 Prot. (E.M.)	16.05.2022	KERKOHEN AKTE	SPAK	MINISTRISE SE MBROJTJES	volumi 10 faqe 260
14	NR. 4319 Prot. (E.M.)	20.05.2022	DERGOHET VENDIM SEKUESTRIMI	SPAK	AGJENSISE SE TRAJTIMIT TE PRONAVE TIRANE	volumi 2 faqe 34
15	NR. 4320 Prot. (E.M.)	20.05.2022	DERGOHET VENDIM SEKUESTRIMI	SPAK	GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE	volumi 6 (file 1) faqe 12
16	NR. 4321 Prot. (E.M.)	20.05.2022	KERKOHEN AKTE	SPAK	AGJENSISE SE TRAJTIMIT TE PRONAVE TIRANE	volumi 8 faqe 14

Tabele me 16 kërkesa nga SPAK fill pas urdhrit të Edi Ramës drejtuar institucioneve shtetërore duke kërkuar informacione 30 vjeçare për Sali Berishën deri tek mbesat e tij që nuk kishin lindur

Menjëherë pas regjistrimit të emrit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, pa u pyetur, edhe pse hetimet ishin zhvilluar për tre vite, prokuroria paraqiti kërkesë për caktimin e masës së sigurimit. Në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit (edhe më pas në vendimet e gjykatave), nuk tregohet as telegrafikisht se si pretendohet të jenë kryer veprat penale. Kërkesat për masa kur nuk është pyetur dhe nuk janë konsideruar argumentet e mbrojtjes janë të paligjshme por ligji është teknikalitet i parëndësishëm kur urdhri vjen nga Edi Rama.

⁸ <https://dosja.al/rama-spak-durimi-ynë-po-soset-e-kemi-gojen-ne-vend-dhe-ne-hetoni-non-grata-n>

Nënshtirimi ndaj urdhrit politik bëri që edhe gjyqtarja Irena Gjoka ta kalonte brenda 3 ditësh kërkesën 210 faqe të prokurorëve, të shihte edhe gati 20,000 faqe materiale në 42 fashikuj të prokurorisë, të shkruante 215 vendim gjyqsor për masat e sigurisë dhe të nxirrte edhe vendimin për sekuestro të 25 pasurive private (se nuk ka asgjë publike në këtë farsë). Standardet ndërkombëtare për leximin me kuptim tregojnë që mund të asimilohen rreth 80-100 faqe në ditë, ndërsa standardet e OKB për proces-verbal mbajtësit e gjykatave (që shtypin më shpejt nga njerëzit e zakonshëm) janë që njeriu mund të shtypë rreth 40 faqe në ditë. Pra gjyqtarja Irena Gjoka ka kapërcyer shumë standarde ndërkombëtare. Ilustim i qartë i standartit të dyfishtë dhe nënshtirimit ndaj urdhrit politik është fakti se po e njëjta gjyqtare, në rastin e dosjes së trafikut ndërkombëtar të drogës të bandës Poja (Troplini) që bleu vota për PS në Durrës e mbajti vendimin e gjykatës italiane mbi fletë arrestet mbi 40 ditë para se t'a firmoste!

Brenda ditës Irena Gjoka vendosi të sekuestrojë edhe të gjithë llogaritë bankare dhe shumicën e pronave të armikut të PS Jamarbër Malltezi, pa kryer asnjë verifikim që disa ishin blerë qysh para 20 vitesh kur punoja për Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, etj. As SPAK e as gjyqsori nuk tregojnë dot asnjë rast ku brenda ditës të jenë marrë masa burgosje dhe sekuestro për çdo llogari bankare dhe çdo pronë të fituar me fonde personale të cilitdo personi që zhvillohen hetime, por mesa duket shteti ka të tjera ligje për armiq të PS. (E dinim batutë humoristike skeçin që thoshte “Ka ligje të tjera për pulat e zeza dhe ligje të tjera për pulat e bardha”).

Tek vendimi i Irena Gjokës i datës 20.11.2023 ka edhe një informacion të rremë që nuk ndodhet në kërkesën e prokurorëve të datës 16.10.2023, por që prokurorët e kanë ngritur disa javë më pas! Bëhet fjalë për pretendimin se VKM prë përdorimin e Bonove të Privatizimit u shfuqizua 7 muaj më pas. Këtë SPAK e ka paraqitur zyrtarisht për here të parë në Dhjetor 2023 në Kuvendin Popullor, pra si e dinte Irena se SPAK do e ngrinte këtë pretendim dy muaj më pas kur tek kërkesa zyrtare ndaj saj nuk figuronte? Këto tregojnë proces të ndotur, komunikim ekstraligjor mes prokurorëve dhe gjyqtarës që ia kane dhënë të gatshëm me flashdisk por që kishin shtuar ndërkaq edhe pretendimin që nuk e kishin në kërkesën zyrtare. Ai pretendim rezultoi i rreme pasi 7 muaj më pas VKM kish hequr të drejtën e përdorimit të bonove vec në procedurë ankandi por nuk cënoi të drejtën e përdorimit të bonove të privatizimit për pronarët e ligjshëm të tokës. Kjo është tjetër tregues i standardeve të dyfishta apo dyfytirësia e drejtësisë me rregji të Edi Ramës.

Tashmë është bërë e qartë se Irena Gjoka nuk përmbushte kushtet për të qenë gjyqtare në kohën kur ka vendosur vendimin për masën ndaj meje dhe ka marrë vendimet për vashdimin e saj në baze të raportimeve të SPAK, pasi ka pasur debim edhe vendim penal të formës së prerë ndaj saj dhe të certifikuar me vulë apostile nga Gjykata e Janinës. Për rrjedhojë e bëjnë një gjykatë jo të formuar me ligj dhe çdo vendim të Irena Gjokës absolutisht të pavlefshëm sipas nenit 128/a të KPP. Por sërish shteti përthyer deri në absurd veç për lojra politike: KLGJ nuk vendos (ndonëse e ka të detyrueshme me ligj që duhet të veprojë brenda 15 ditësh) pasi pret konfirmimin nga Prokuroria e Përgjithshme paçka se vendimi i Gjykatsë së Janinës është me vulë apostile, Prokuroria e Përgjithshme kinse po heton prej 15 muajsh por që kalon letrat nga Ministria e Drejtësisë, ku Ministri Manja thërret në raportim kreun e SPAK sipas dëshirës, dhe Ministria ia con Gjykatës së Athinës e jo asaj të Janinës.

Në seancën e shuarjes së masës më 08.11.2023 (15 ditë burg pa vendim të zbardhur) unë i drejtova disa pyetje gjyqtarës Irena Gjoka lidhur me nënshtirimin politik të gjyqtarës, por as nuk

ju përgjigj dhe bëri kinse sikur nuk ekzistonin. Kjo është ngritur disa herë por gjykatat kanë preferuar të mbyllin sytë e mos përgjigjen, ndonëse vendimi nr. 55 datë 18.12.2012 i GJK i bën nul vendimet që nuk respektojnë standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqsore, përfshirë edhe pretendimet e -palëve.

Ngjashëm edhe në seancën e Apelit të Diligjencës së Katërt unë i drejtova disa pyetje gjyqtarës Ilirjana Olldashi lidhur me nënshtrimin politik të SPAK dhe që kjo është vetëm çështje politike, por gjyqësori i kontrolluar pretendoi se këto argumente nuk ishin ngritur e nuk ju përgjigj, në shkelje të detyrimit të arsyetimit të vendimeve gjyqsore (vendimi 55 datë 18.12.2012 i GJK).

Pas kësaj, prokurorët e SPAK e konsideruan të tepërt ligjin që i detyron të shkruajnë raporte 2-mujore dhe më lanë mbi 3.5 muaj në arrest shtëpie pa raport diligjence fare (27 Qershor 2024 – 12 Tetor 2024). Edhe kjo është shkelje e ligjit por shkeljet janë bërë normë në këtë proces kafkian. Në çdo dy muaj unë duhej të merrja vendimin e gjykatës për rishikimin e masës, bazuar në raportin dymujor të diligjencës të prokurorisë por kjo nuk është respektuar asnjëherë. Edhe në rastet kur prokuroria nuk e kryen këtë detyrim ligjor, ligji e detyron gjykatën ta ndër marrë këtë gjë *ex-officio*, por duket se “ka ligje të tjera për armiq të PS” dhe gjyqtarja e hetimeve nuk kishte problem kapercimin e afateve ligjore në shkelje të drejtave procedurale.

Në përpjekje për të sajuar prova për të justifikuar procedimin penal të paligjshëm, prokurorët kanë detyruar disa ekspertë të hartojnë ekspertiza sipas urdhrave të tyre dhe jo sipas bindjes së pavarur të ekspertëve dhe metodologjisë që përcakton ligji. Nje gje e tille pohohet ne vetë ekspertizat e firmosura nga ekspertet. Në bazë të këtyre ekspertizave joligjore e të pavlefshme une jam mbajtur ne arrest për 20 muaj. Konkretisht, prokurorët kanë detyruar ekspertët që të vlerësojnë objektet e rrënuara 60 vjeçare (disa prej të cilave pa dritare dhe pa çati ose me çati me lllamarina apo asbest), me objekt palestra, magazine, etj, sikur duhej të privatizoheshin me vlerë prej thuajse 1,000 euro/m² (sipas një vendimi të Entit Kombëtar të Banesave që fliste për apartamentet e reja që do shiste Enti i Banesave në vitin 2007 e jo për rrënoja të depove 60 vjeçare).

Në mënyrë të turpshme të njëjtët prokurorë që kanë pretenduar që unë dhe familjet e tjera pronare të paguanim në vitin 2007-2009 për objektet e rrënuara, të ndërtuara para 60 vitesh një çmim gati 1000 euro/m², vetë kanë blerë objekte me vlera qesharake shumë vite me pas. Prokurorja Millonai, referuar deklarimeve të saj ne procesin e vetingut ka pretenduar se në vitin 2016 ka lidhur kontratë për blerje apartamenti fringo të ri në Tiranë, në një zonë që koïncidon afër zonës së ish Klubit Partizani (tek Astiri) me vlerën 476 euro/m²! Mesa duket edhe kjo shifër është konsideruar e lartë sepse ndërtuesi e ka pritur 7 vjet që të kryente pagesën. Ajo e justifikoi (dhe vetingu ia pranoi) se vlera e ndërtimeve të reja në Tiranë në 2015 ishte më pak se 400 euro/m²!

Po kështu, prokurori tjetër i çështjes Arben Kraja ka deklaruar në deklarinimin vjetor të pasurisë së tij se ka blerë tokë në Gjirin e Lalzit, të cilën së bashku me 3 objekte ushtarake brenda e ka blerë në vitin 2006 për vetëm 5 euro/m²! Edhe prokurorit Kraja i është pranuar blerja e tokës së bashku me 3 objekte ushtarake brenda për vetëm 5 euro/m².

Këto fakte tregojnë se jo vetëm prokuroria ka përdorur standarte të dyfishta për këtë procedim penal dhe caktimin e masës së arrestit ndaj meje, por se edhe gjykata i ka pranuar ato si arsyetim për mbajtjen e kësaj mase.



Per "armiqtë e Partisë Socialiste" keto karakatina
pa dritare e pa tavan duhen vlerësuar me cmimin
1,000 euro/m², dhe kjo 15 vite pasi nuk ekzistojnë

Foto: gjendja e disa prej objekteve të ish Klubit Partizani në 2008

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga hetimet e kryera nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë porosie nr. *** në datën 4.12.2015, për blerje apartamenti me shoqërinë *****, Objekti i kontratës është blerje e një apartamenti me sip. ndërtimi 94.5 m², kati i pestë, Komuna ***, Tiranë. Vlera e apartamentit sipas kontratës është 45,000 euro dhe çmimi do likuidohet:

- Vlera prej 10,000 eurosh është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës në llogarinë e shoqërisë;
- Diferenca prej 35,000 eurosh do të likuidohet në momentin e hipotekimit të godinës dhe lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes.

Sipas shkresës së “Credins Bank”, datë 4.12.2015, rezultoi se nga llogaria e subjektit ka kaluar në favor të shoqërisë *****, shuma prej 1,379,100 lekësh, bazuar në kontratën nr. ***. Nuk rezultoi të jetë lidhur kontrata përfundimtare e shitblerjes nga ana e subjektit për këtë pasuri.

Lidhur me disa gjetje të Komisionit për këtë pasuri është pyetur subjekti në lidhje me vendosjen e këtyre termave kontraktorë ku pjesa më e madhe në vlerën prej 35,000 eurosh, do paguhej në momentin e hipotekimit të godinës dhe nëse ishte regjistruar kjo godinë dhe a ishte lidhur kontrata e shitblerjes për këtë apartament.

Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e tij ka deklaruar se ka qenë në pamundësi që të shlyente të gjithë vlerën e apartamentit apo të paguante ndonjë vlerë të konsiderueshme për shlyerjen e tij. Për këtë arsye në momentin e lidhjes së kontratës, subjekti ka paguar shumën prej 10,000 eurosh, ndërsa pjesën tjetër do ta siguronte nëpërmjet një kredie, e cila mund të merrej pas regjistrimit të pallatit. *Pallati nuk është regjistruar ende dhe nuk është lidhur as kontrata e shitblerjes, duke mos u bërë e mundur as marrja e kredisë dhe as shlyerja e pjesës së mbetur të vlerës, në shumën 35.000 euro.*

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit e ka pasqyruar saktë këtë pasuri si në deklaratën “Vetting”, ashtu dhe në deklaratat periodike vjetore. Burimet e ligjshme financiare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie deri më sot janë deklaruar saktë nga subjekti dhe për këtë Komisioni nuk konstatoi parregullsi.

Të ardhura për pagesën e kryer të kësaj pasurie të parë janë verifikuar nga Komisioni ku ka rezultuar se shuma prej 1,379,100 lekësh është përballuar nga llogaria bankare që ka pasur subjekti i rivlerësimit, shumë e cila ka kaluar nëpërmjet transfertës bankare datë 4.12.2015, te pala shitëse. Veprimet financiare të kryera mbi këtë pasuri janë pasqyruar në analizën financiare.

Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie apartament nuk u konstatuan problematika, pasi çmimi/m², sipas kontratës së porosisë, rezulton në vlerën prej 476 eurosh (rreth 60,000

7

Sipas vetingut te partise, ndertesat e reja per banim ne 2015 vleresohen me 400 euro/m2

lekë/m²). Referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4 të vitit 2015, kosto mesatare e ndërtimit për qytetin e Tiranës është në vlerën 39,193 lekë/m².

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë për veprimet e kryera bazuar në kontratën e porosisë për përfitimin e kësaj pasurie të paluajtshme, si dhe ka pasur burime financiare të ligjshme.

Foto: Pjesë nga dokumenti i vetingut i Prokurores Millonai lidhur me justifikimin për çmimin prej vetëm 476 euro/m2 për apartamentin e ri që do të ndërtohej në 2016.⁹

⁹ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendim-Enkeleda-Millonai.pdf>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

NDRYSHIMET
E INTERESAVE PRIVATE
PASURI TË PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Përkthyeri hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloji pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Interesa këto: që kanë lidhje me Ju, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Bleu sipërfaqe tokë që 5600 m ² plus tre objekte brenda saj, me kalëz - Durrës. Komuna [redacted]	Beguar (pjesa ime) 466 000 lekë. (katërdhjetë mijë)	1/6
	data 7.12.2006, të notu [redacted] Pjua për zotësi të 1/6 = pjesa që bleu.		

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Arben Kraja

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

"Periodik/Vjetor" 3

Foto: Pjesë nga deklarata e prokurorit tjetër Arben Kraja depozituar në ILDKP ku ka deklaruar se ka blere tokë në Gjirin e Lalzit, të cilën së bashku me 3 objekte ushtarake brenda kinse e ka blerë për vetëm 5 euro/m²¹⁰! Komisioni i vettingut edhe prokurorit Kraja i ka pranuar blerja e tokës së bashku me 3 objekte ushtarake brenda për vetëm 5 euro/m²¹¹

¹⁰ <https://politiko.al/ditari-i-opozites/skandal-i-spak-ut-jamarber-malltezi-demoncon-blerjen-e-tokes-n-i522298>

¹¹ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/01/Vendim-Arben-Kraja.pdf>

Trashëgimtarët e pesë familjeve themeluese të Tiranës nuk u bënë pronarë me proces privatizimi. Pronarë këto familje ishin prej 100 vitesh, përmes blerjes së tokës private. Në dokumentet e viteve 1940 (matjet nga autoritetet Italiane që urdheruan rekuizicionin 6 mujor) SPAK dëshmon se e gjithë toka në fjalë ishte private dhe nuk kishte asnjë cm² tokë shtet në atë zonë. Gjithashtu dëshmon se kurrë nuk ka pasur shpronësime nga autoritetet Italiane por Rekuizim të përkohshëm 6-mujor të botuar në Fletoret Zyrtare të kohës, derisa kapitulloi Italia në Shtator 1943.

Procesi i kthimit të pronës është kthim i sendit të vjedhur tek pronari legjitim. Ky proces zgjati nga 1994 deri në 2007, kur pas dhjetëra vendimesh qysh nga viti 1995 (njohje prone e pjesërisht kthim), prona e vjedhur iu kthye pesë familjeve pronare. Në këtë pronë të pronarëve të ligjshëm, jashtë çdo rregulli ishin futur 42 familje informale të cilët banonin në kushte mjaft të vështira pasi ashtu ishin katandisur godinat.

Për të gëzuar sendin e vjedhur nga rregjimi komunist, pronarët fisnikë u detyruan nga ligji të blejnë edhe barrakat e ndërtesat e uzurpuara. Pra, shteti jo vetëm që ua vodhi pronën dhe ua mbajti atë për 60 vjet pa qera, por tani pronarët e ligjshëm duhet të prisnin edhe 3 vjet, për të blerë ato barraka që as nuk i duheshin, e që për më tepër, ishin të uzurpuara. Dhe shteti as nuk pagoi qira për 3 vite që zgjatën procedurat e privatizimit siç e parashikonte ligji.

Pronarët u detyruan të paguajnë edhe 700,000 \$ për ndërtimet e uzurpuara tek njëri klub, si dhe mbi 100,000 \$ për klubin tjetër. Krahasojeni pak me çmimin 1 Euro me të cilin Edi Rama i bëri dhuratë Carlo Bolinos 4,120 m² tokë dhe ndërtesë 2-katëshe, caktuar për gjimnaz.

Këtë pronë private, pronarët e zhvilluan duke respektuar çdo ligj të vendit, por edhe me humanizëm e respekt për komunitetin. Ata strehuan 42 familje informale falas, morën një nga emrat e shquar të arkitekturës botërore për të konceptuar zonën, si Daniel Libeskind, bënë ndërtime miqësore me mjedisin. Nëse do të kishim marrë leje klienteliste do të kishim ndërtuar fjetore në gradaçela që të zënë qiellin dhe diellin, nëse do kishte pastrim parash do kishim shitur me çmim të çmendur se do kishim plot para për të pastruar. Por jo ne, fisnikët e Tiranës!

Nga projekti ynë, publiku fitoi mbi 2,000 vende pune, miliona euro taksa, krijimin e parkut urban më të madh në Tiranë përmes mbjelljes së mbi 2,200 pemëve, kopshtin/çerdhen më të mirë në Tiranë, ndërtesa miqësore me mjedisin, zonën me ajrin më të pastër në Tiranë, faltore për besimtarët, vepra arti si edhe zgjidhjen e problemit të strehimit të 42 familjeve informale.

Nëse do ishte përdorur pushteti nga Sali Berisha, siç e përdor Edi Rama:

1. Nuk do zgjaste 13 vjet kthimi i tokës së vjedhur tek i zoti.
2. Nuk do kish zgjatur 3 vjet privatizimi i ndërtesave në tokë pronare, por veç 2 ditë (se Edi Rama kinse kalon 17 firma në ditë – rasti i Inceneratorit të Elbasanit – dhe SPAK nuk ndihet).
3. Nuk do kishim paguar 800,000 \$ për disa barraka të zëna forcërisht, por shumë herë më lirë, ose 1 euro, si psh. Bolino ose si vellai i Edi Rames.
4. Do kishim edhe ne, pronarët e tokës, VKM nominative, siç ka nxjerrë Edi Rama 4 VKM në emër të kompanisë së Bolinos, për t'i kaluar atij tokën tone të cilën ramë dakort t'ia falnim komunitetit për shkollë. Ose si Ligjin Fusha, apo dhjetra akte të tjera si për Portin e Durrësit. Limionin, Klubin e të vëllait të Ramës, etj.

5. Do kishim marrë, si kunati i Edi Ramës, dhjetëra tendera me para publike. Por asnjë trashëgimtar Begeja, nuk ka marrë asnjë lek fonde publike gjatë qeverisjes së PD.
6. Nuk do të kishim paguar taksa, se do të përfitonim si "strategjik".
7. Nuk do kishim shpenzuar token dhe parate tona për t'i dhuruar komunitetit çerdhen dhe kopshtin më të mirë në Tiranë.
8. Nuk do e zhvillonim tokën me parametra të pranueshëm urban, por me gradaçela që u bllokojnë ajrin dhe diellin gjithë banorëve.
9. Nuk do kishim shpenzuar 2,500 m² dhe mbi 500,000 € për të sistemuar 42 familje informale me banesa, por do i kishim nxjerrë në rrugë, duke përdorur policinë e shtetit për këtë gjë siç e përdor Edi Rama ndaj informalëve tek Astiri dhe Bregu i Lumit.
10. Do kishim marrë 3 vite qira nga shteti "deri në përfundim të procesit të privatizimit" siç është detyrimi ligjor.
11. Nuk do të ishte kthyer veç 8% e pronës që familja Begeja kishte në pronësi para ardhjes në pushtet të komunisteve, por do ishte kthyer 100% e saj.

Këto janë tipare të përdorimit të pushtetit, për interes të miqve të Ramës, dhe këto batërdi i shohim çdo ditë sot, por asnjë nga këto veprime të keqpërdorimit të pushtetit për miqtë, nuk kanë ndodhur nga Sali Berisha por nga Edi Rama!

Prandaj, kam nderin t'ju rikujtoj se:

1. Procedimi penal nisi me kallzimin e Ballës se **pronësia e tokës** nuk ishte e pronarëve. SPAK për këtë nisi procedimin penal brenda ditës dhe këtë e shënon si dyshim kur vendosi të kërkojë masë arresti. Pronësia private është e qartë që nuk ka ndryshuar dhe janë të botuar në Fletoret Zyrtare të 1942-1943, por SPAK shpenzoi muaj në Arkiv të Shtetit dhe biles harxhoi disa muaj letërkëmbime me Italinë dhe mori mbi 12,000 faqe krejt palidhje në përpjekje për të injoruar dokumentet zyrtare të botuara në fletoret zyrtare të kohës. Kallzimi i Ballës rezultoi kallzim i remë por SPAK dhe Gjykatat refuzojnë të nisin procedim penal pasi disa janë mbi ligjin. Nga ana tjetër u vërtetua se është vjedhur tokë publike në Dhërmi, të cilën Edi Rama i dha edhe status investitor strategjik deputetes Xhacker por gjykata vendosi që as mos të hetohet Xhacker dhe jo më të arrestohet!
2. Masat u vendosën me pretendimin se Berisha ka miratuar **ligje dhe VKM nominative** POR në 4 vjet hetime nuk ia nisën GJK për vlerësim nëse ndonjë ishte nominative. Tani në akuzë pranojnë që asnjë ligj dhe asnjë VKM nuk ka qenë nominativ, por se ka përfituar edhe Malltezi nga këto ligje! Ndonëse premisat dolën të rreme, prapë kanë vijuar mbajtjen e masave. Në fakt, Edi Rama ka nxjerre ligje të personalizuara si ligjin Fusha (konfirmuar si ligj nominativ nga GJK), apo 4 VKM të personalizuara që grabitën tokën (pjesërisht të familjes Begeja) që ishte caktuar për gjimnaz, vec për tia falur mikut të vet Carlo Bolino. Edi Rama ka nxjerrë VKM të personalizuar që i dhuron Klubit Partizani ku ka të vëllain drejtor, plot 37,200 m² tokë dhe disa ndërtesa ndonëse ka pretendime pronësie dhe objekti ishte brenda planit të perhapjes së FA, por ka ligje të tjera për Edi Ramën dhe të tjera për Berishën dhe Malltezin.
3. U pretendua se Berisha kreu **ndryshimin e destinacionit** në 2006, por del se i kreu Rama si në 2004 (17,200 m²), si në 2006 (7,000 m²) dhe gjithë tjetrën e shpalli "zhvillime të reja me parametra të lartë urban" me vendimin KRRT nr. 238 dt. 27.12.2008. Ndërsa Berisha ka firmosur *ex-officio* në 2006 të gjitha ato 11 ndryshime destinacionesh që ia ka

sjellë Edi Rama pasi që sipas Kartës së Autonomisë Vendore të Këshillit të Evropës, planifikimi dhe kontrolli i territorit janë tagra të pushtetit vendor. Edi Rama sot po shkel cdo ditë vendimin 29/2006 të GJK me lejet e zhvillimit që firmos për cdo objekt në cdo qytet të Shqipërisë, por duket se SPAK zbaton tjetër Kod Penal për Edi Ramën.

4. Në vendosjen e masave shkruajtën sikur ka nevojë të hetohet nëse ajo tokë ishte në **Planin e Përhapjes së Forcave të Armatosura**. Kjo ishte gënjeshtër pasi qysh në 2022 kishte përgjigje nga Shtabi i Forcave të Armatosura që nuk ka qenë kurrë. Për më tepër edhe pak ditë para se të kërkonin masat vetë OPGJ e dërguar nga prokurorja pa dokumentin sekret e shkruajti më 22.10.2023 se nuk ka qenë as në Planin e Përhapjes së vitit 2004. Pavarësisht kësaj prokurorët kërkuar arrest për z. Malltezi edhe për këtë shkak. Thirrën mbi 30 ushtarakë në tentativë të rrëzojnë Dekretin e Presidentit me dëshmitarë. Urdhëruan arrest për mua ndonëse kjo nuk ka qenë kurrë në Planin e Përhapjes së FA, SPAK bën “idiotin e dobishëm” kur për tjetërsimin e Bazës Ushtarake Detare të Limionit që vetë gjykata thotë se rrezikon sigurinë kombetare SPAK nuk ka kërkuar asnjë masë! Edhe për tjetërsimin e bazave ushtarake detare të Porto Romanos dhe Shëngjinit përsëri SPAK nuk ka kërkuar asnjë masë se dalin Edi Rama, ministria Olta Xhacca dhe presidenti Bajram Begaj!
5. **Hetimi ka nisur ndaj personit dhe jo për ndonjë vepër penale**. 3 vjet hetime kinse pa emër personi në hetim (01.12.2020 - 02.10.2023), por ka hetime qysh në 2021 në emër të Berishës dhe gjithë familjarëve të tij. Hetime për vepër penale apo gjueti shtrigash?
6. Pas urdhrit të Edi Ramës ndaj SPAK për ndëshkim penal ndaj Sali Berishës (fjala në Kongresin e PS më 09.04.2022), SPAK nisi breshëri 16 kërkesash në cdo institucion **për të hetuar për 30 vjet** Berishën dhe në 3 breza deri tek mbesat e tij qysh në 1995 kur ato ende nuk kishin lindur. (shkresa nga sigurimet shoqërore që kanë hetuar me emrat edhe të mbesave qysh nga 1995).
7. Malltezi u **mbajt në arrest pa raport diligence përmbi 3.5 muaj** që është shkelje tjetër ligji. Diligjenca e fundit 2-mujore është e datës 27.06.2024 ndërsa akuzën e shpallën në Tetor 2024. Gjykata duhej të vepronte *ex-officio* për këtë shkelje ligji por dështoi të zbatojë ligjin. Gjithashtu SPAK vendosi zgjatje hetimesh edhe përtej afatit 1 vjeçar pas rregjistrimit të emrit të personit nën hetim.
8. **SPAK gënjeu-falsifikoi** kur pretendoi se VKM për përdorimin e bonove të privatizimit ishte **shfuqizuar 7 muaj më pas** (pra u miratua veç për pak familje pronare). Në fakt, ishte shfuqizuar vetëm pika që fliste për ankandet ndërsa pika për pronarët e tokës nuk kish ndryshuar. Ky mashtrim (i prokurores nga Elbasani së promovuar në SPAK në kohën kur Taulant Balla ishte drejtues politik i PS për Elbasanin) gjendet ende sot në akt-akuzë.
9. SPAK mashtron dhe mashtrimin e ka bërë pjesë të akt-akuzës kur shkruan se të ardhurat e Malltezit nga zhvillimi i pronës së tij janë pjesë e Bashkësisë Ligjore pasi **neni 77 i Kodit të Familjes** shpjegon se të ardhurat nga trashëgimia dhe zhvillimi i saj janë pjesë e pasurisë vetjake.
10. Malltezi ka paraqitur **kallzime penale për falsifikim** dokumente zyrtare dhe fillim të paligjshëm të ndjekjes penale të dy prokurorëve, por kolegët e tyre në SPAK vendosin mosfillim procedimi penal. Kallzimi u paraqit në Prokurori të Tiranës e jo në SPAK, por për çudi përgjigja erdhi nga SPAK që vendosi mosfillim procedimi penal për kolegët. Rast unikal që kolegu brenda zyrës të vendosë për kolegun dhe mos pranojnë që një zyrë tjetër prokurorie të hetojë që të shmanget konflikti i interesit.

11. Prokurorët kryen **shkelje të të drejtave kushtetuese** për proces të rregullt ligjor duke sekuestruar përmbi një vit dosjen civile të shpifjes që padita Taulant Ballën. Kjo është në GJEDNJ e cila tashmë po i kërkon Shqipërisë të paguajë dëmshpërblim për këtë gjë.
12. Malltezi ka kërkuar procedim penal për kallzimin e rremë të Taulant Ballës por prokurorët e SPAK vendosën mosfillim të procedimit penal. Ligje të tjera për ministrat e PS.
13. Malltezi ka kërkuar fillim **procedimi penal për Edi Ramën** që ka rezultuar me vendim gjykatë të formës së prerë që ka shpërdoruar detyrën, ka sjellë dëm financiar mbi 340,000 euro, ka refuzuar zbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe ka ndërmarrë veprime në kundërshtim të vendimit të formës së prerë të gjykatës. POR dëmi ekonomik shkaktuar në buxhetin publik nuk përbën arsye për të nisur procedim penal për këta prokurorë kur shihet se këtë dëm ekonomik e ka shkaktuar Edi Rama.
14. Malltezi ka masë të pabazuar në ligj për moskomunikim me askënd përvec familjarëve në të njëjtën banesë ndaj nuk ka vajtur në seancat për shqyrtimin paraprak, duke shkruajtur në njoftimet nga gjyqtarja se ka vendim gjykatë në fuqi që ndalon komunikimin me këdo tjetër. Masa për moskomunikim me askënd tjetër nuk parashikohet në Kodin Penal, dhe biles këtë masë nuk e kanë as personat e burgosur, por ka ligje të tjera për armiq të PS.
15. Prokurorët sajuan ekspertiza nga persona të papranueshëm si ekspertë të pavarur përfshi babai i hetuesit të BKH dhe militantit të PS (Zyba), që rezultoi krejtësisht e rreme.
16. Në mungesë të fakteve dhe provave, prokurorët pretendojnë si përfitim personal të Berishës pagesa që unë kam kryer për trajtimin e fëmijëve autikë! Bamirësia që unë kryej me paratë e mia për njerëz në nevojë merret si përfitim i Berishës?!
17. SPAK pretendon si përfitim personal dhe elektoral të Berishës edhe sponsorizimin me 4,600 euro që u bë (për llogari të Ministrisë së Kulturës) në 2013 për shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të dy këngëtarëve që u paguan nga kompania jonë private për të nderuar këngëtarin shqiptarë dhe që as nuk u shpenzuan para publike. Nga ana tjetër, vec dy ditë para zgjedhjeve të 11 Majit 2025 Edi Rama vendosi me vendim personal të japë 7 milion euro nga paratë publike për të organizuar “Giro d’Italia” në Shqipëri duke bllokuar gjithë trafikun dhe aktivitetet e opozitës dhe SPAK nuk ekziston për këtë gjë.
18. Nuk ka asnjë lek dëm në financat e shtetit, përkundrazi, shteti përfitoi rreth 800,000 \$ nga ndërprerja e gjendjes së paligjshmerisë që mbretëronte prej vitesh. Për këtë që nuk ka fare para publike urdhërohet arrest, ndërsa për 30 milion euro para publike dëm (skema 5D), drejtorët u dënuan me punë në komunitet. Këto janë standardet e drejtësisë me rregji.
19. Malltezi vijon prej thujse 20 muajsh në arrest ndonëse pretendimet rezultuan të rreme. Ka me dhjetëra shkelje ligjore në këtë farsë dhe asnjë nuk ka ndodhur rastësisht¹².

E gjitha kjo sagesë që u nis me urdhra politikë nuk ka as fakt penal e as çështje publike por veç kthim të sendit të vjedhur dhe zhvillim të pronës private. Të tre ne zhvilluesit e pronës së të parëve tanë jemi krenarë që i kthyem dinjitetin të parëve tanë duke (i) respektuar pronarët e ligjshëm, (ii) zgjidhur edhe hallin e strehimit të 42 familjeve informale, (iii) duke i dhuruar komunitetit kopshtin dhe çerdhen më të mirë në qytet, (iv) zhvilluar zonën me shumë dashuri jo me qiellgërvishtës por (v) duke marre arkitekt dinjitoz që krijoi komunitet të qëndrueshëm, (vi) krijuar me parkun urban më të madh në Tiranë, (vii) me dhjetëra vende çlodhëse dhe vepra arti.

¹² <https://www.syri.net/politike/680468/me-prova-si-ka-zbatuar-dhe-po-zbaton-drejtesia-urdherat-politike-te-edirames-kunder-liderit-te-opozites-sali-berisha/?gjuha=En>